



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1263 Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 178, Datë 17 / 09 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.87 Regj., datë 13.06.2018, në emër të shtetasve O K dhe M K¹, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të përkatësisë prindërore, (z.J K është babai i ankuesve, vërtetuar me Certifikatën e Zyrës së Gjendjes Civile/Njësia Bashkiake nr.2, date 14.06.2018), nga ana e Bashkisë Mallakastër dhe Këshillit Bashkiak Mallakastër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Përmes ankesës së sjellë pranë Zyrës së Komisionerit, z.O dhe z.M K shprehen se janë diskriminuar nga ana e Bashkisë Mallakastër dhe Këshillit Bashkiak Mallakastër, përmes mos shqyrtimit të kërkesës së tyre lidhur me shfuqizimin e Vendimit nr.27, datë 29.05.2002 pika III e tij “Të miratojë emërtimin e rrugëve si më poshtë: Rruga në drejtim të KPTHN-së “Rruga Mehmet Shehu” ”dhe kanë kërkuar: “...riemërtimin e kësaj rruge, me një emër të denjë për pasqyrimin e vlerave më të mira, të qytetarëve të Ballshit, Mallakastrës, por dhe gjithë Shqipërisë”.

¹ Gjatë paraqitjes së problematikës së tyre pranë KMD-së zotërinjtë janë asistuar nga z.D D, çka pasqyrohet dhe nga komunikimi zyrtar me e-maile mes z.D dhe Institucionit të KMD-së.

Pasi subjektet ankues kanë shpjeguar lidhjen familjare me z.J K (referuar Certifikatës së Zyrës së Gjendjes Civile të depozituar në dosje, janë të bijtë e tij), kanë dhënë një panoramë të gjerë të kalvarit të vuajtjeve të familjes së tyre nga ish-regjimi komunist, duke renditur kronologjinë e ngjarjeve që nga arrestimi i paligjshëm i babait të tyre, z.J K, ekzekutimi i tij, dëbimi dhe internimi i nënës dhe shtatë fëmijëve (përfshirë dhe ankuesit), sekuestrimi i pasurisë së tyre, etj.

Në procesverbalin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të datës 20 shkurt 1951, sjellë bashkëngjitur ankesës nga subjektet ankues, ndër të tjera citohet se: *“...pavarësisht nëse është ndonjë nga ata që mendojmë ne apo jo, ne duhet të zbulojmë patjetër burimin dhe njerëzit e këtij atentati. Është e nevojshme politikisht të marrim masa represive të jashtëzakonshme pa marrë parasysh ligjet në fuqi. Një masë të tillë e kemi marrë edhe kur u vra B B, dmth, kemi pushkatuar edhe jashtë ligjeve në fuqi. Unë mendoj se masa që duhet të marrim të jetë në një shkallë të tillë që elementi që përpunohet, elementi reaksionar i tipit Kacaruhe etj, që sonte ti arrestojmë rreth 100 ose 150 vetë nga të cilët 10 ose 15 veta ti pushkatojmë, duke zgjedhur sigurisht nga ata më kryesorët mbasi kanë dashur të organizojnë atentate të tjera. Kjo masë të procedohet edhe me një masë tjetër spastrimi nga Tirana të familjeve reaksionare brenda një muaji. Ne duhet terrorit ti përgjigjemi me terror dhe këtë mund ta bëjmë me plot ndërgjegje dhe gjakftohtësi. Ne i kemi përgatitur listat e arrestimeve dhe po të jeni dakord dhe ju veprojmë që sonde”.*

Në vijim të ankesës së tyre, z.O dhe z.M K shprehen se: *“...Babai ynë J K është arrestuar, burgosur, torturuar dhe vrarë sipas planit të sipërcituar të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë. Me vendimin e datës 02.03.1951 të Kryeministrit, për motive politike, të gjithë pjesëtarët e familjes jemi dëbuar nga Tirana duke u dërguar në internim për tre vjet, nga data 03.03.1951 deri me 05.03.1954, në Skrapar, Çorovodë, fakt i provuar në shkresën e datës 02.03.1951 të Arkivës Qendrore të Shtetit. Në cilësinë e dy djemve të të ndjerit Jonuz Kaceli, pushkatuar në moshën 43 vjeçare, theksojmë se ka qenë totalisht i pafajshëm dhe se është arrestuar, vrarë dhe zhdukur vetëm për arsye politike. Trupin e Tij e kemi gjetur në vitin 1993, në një gropë të hedhur së bashku me të vrarët e tjerë, të lidhur me tel me gjemba, në breg të lumit, tek Ura e Beshirit, në fshatin Menik të Tiranës.*

Emërtimi i rrugës së qytetit Ballsh me emrin e diktatorit Mehmet Shehu, ka sjellë trajtim diskriminues ndaj nesh si fëmijë të internuar dhe me baba të pushkatuar nga ky kriminel.

Në njërën anë, jemi Ne që babai na u pushkatua dhe u zhduk për mbi 40 vjet me radhë dhe në anën tjetër janë trashëgimtarët e kriminelit Mehmet Shehu, të cilët nderohen nga Bashkia me këtë vendimmarrje, duke e mbajtur emërtimin e një rruge, në emër të personit që ka kryer Krime kundër njerëzimit”.

Subjektet ankues shprehen se fakti që një institucion publik, siç është Bashkia e Mallakastrës dhe Këshilli Bashkiak i Mallakastrës, u ka refuzuar atyre shqyrtimin e kërkesës për heqjen dhe ndryshimin e emërimit të rrugës “Mehmet Shehu”, përbën trajtim diskriminues ndaj tyre.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.821/2 prot, datë 19.06.2018 të Komisionerit janë njoftuar për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës si dhe u është kërkuar informacion mbi pretendimin e

²Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

ngritur nga zotërinjtë Kaceli: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Kryetari i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Mallakastër dhe Prefekti i Fierit³.

- Me shkresën me nr.1480/2 regj., datë 27.06.2018 drejtuar Komisionerit, Kryetari i Bashkisë Mallakastër, ka parashtruar se:

“Me datë 09.11.2017 në adresën elektronike të Bashkisë Mallakastër ballshi@bashkiamallakaster.gov.al është dërguar kërkesa për shfuqizimin e vendimit nr.27, datë 29.05.2002, pika III, “Miratimi i emërimit të rrugëve si më poshtë: Rruga në drejtim të KPTHN-së “Rruga Mehmet Shehu” dhe riemërimit të kësaj rruge, me emërtim të denjë për pasqyrimin e vlerave më të mira të qytetarëve të Ballshit, Mallakstrës por dhe gjithë Shqipërisë. Sqarojmë se kjo adresë e-maili është adresë që përdoret për komunikim ndërinstitucional, ndërsa adresa për kërkesa për informacion dhe për komunikim me qytetarët është info@bashkiamallakaster.gov.al, gjë e cila është e pasqyruar edhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Mallakastër. Ngatërrimi i kërkesit në përdorimin e adresave elektronike ka sjellë edhe moskthimin e përgjigjes.

Gjithashtu vlen të theksohet fakti që për shfuqizim vendimesh subjektet e interesuara duhet ti drejtohen Këshillit Bashkiak që është organ përfaqësues dhe jo në varësi të Bashkisë Mallakastër ose organeve të gjyqësorit për të kërkuar pavlefshmërinë e tyre”

Theksojmë faktin se, megjithë marrjen dijëni të kërkesës së Komisionerit për sqarimin e rrethanave dhe te fakteve të pretenduara nga ankuesit, nga ana e Këshillit Bashkia Mallakastër nuk u soll asnjë përgjigje zyrtare apo dokumentacion.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Paraprakisht KMD vlerëson se duhet kryer një qartësim në lidhje me emërtimet e institucioneve. Në kuadër të trajtimit të çështjes Bashkia Mallakastër do të trajtohet si Njësi e Vetëqeverisjes Vendore në tërësi e cila vepron nëpërmjet dy organeve shumë të rëndësishme: Kryetari i Bashkisë si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ vendimmarrës, përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak.

Emërtimi i përdorur nga Bashkia Mallakastër si në shkresën drejtuar KMD-së, ashtu edhe në përgjigjet e e-maileve drejtuar ankuesve duke i trajtuar Bashkinë Mallakastër dhe

³Të tria institucionet kanë marrë dijëni për shkresën e KMD-së që në datën 21.06.2018; referuar lajmërimit nga Posta Shqiptare, me Lajmërim marrje me kod postar : RR 372 858 834 AA, RR 372 858 817 AA, RR 372 858 879 AA.

Këshillin Bashkiak të Bashkisë Mallakastër si dy entitete të ndara, është i gabuar dhe krijon konfuzion, sidomos në korrespondencën me qytetarët.

Sa i takon pretendimit të ankuesve se janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese nga ana e Bashkisë Mallakastër (BM):

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Ky parim përshkon edhe nenin 48 të Kushtetutës sipas të cilit *“Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj”.*

Neni 19 Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” sanksionon se: *“...E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes 1. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t’u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. 2. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t’i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj”.*

Bazuar në korrespondencën dhe dokumentacionin e depozituar nga palët pranë KMD-së, ka rezultuar se kërkesa drejtuar Bashkisë Mallakastër⁴ për heqjen dhe ndryshimin e emërimit të rrugës “Mehmet Shehu”, si emërtim diskriminues, ka qenë e përsëritur nga ana e ankuesve. Pavarësisht pretendimit se Bashkia Mallakastër ka refuzuar shqyrtimin e kërkesës për heqjen dhe ndryshimin e emërimit të rrugës “Mehmet Shehu”, konstatohet se nga ana e Bashkisë Mallakastër i është kthyer përgjigje ankuesve por jo në lidhje me pretendimet e tyre thelbësore por në lidhje me emailt e BM

⁴Procedura është ndjekur nga z.D.Dema, i cili është një ndër personat e cituar në kërkesat e tyre drejtuar Bashkisë Mallakastër dhe Këshillit Bashkiak Mallakastër, dhe që po ashtu ka asistuar dhe mbështetur me dokumentacion provues dy ankuesit gjatë shqyrtimit administrative të ankesës së tyre pranë KMD-së.

dhe llojet e tyre, gjë që faktohet nga komunikimi me e-mail mes z.Dema⁵ dhe Bashkisë Mallakastër⁶.

Përgjigjja e Bashkisë, *prima facie* duket sikur e përmbush detyrimin për të dhënë informacion, por realisht nuk ndihmon në zgjidhjen e ankesës së subjekteve përmes adresimit të saj tek organi kompetent.

Lidhur me pretendimin se Bashkia Mallakastër i ka diskriminuar ata duke mos shqyrtuar kërkesën e tyre për ndryshim të emërimit të kësaj rruge, Komisioneri vlerëson se është kompetencë e Bashkisë të vendosë për emërtimin e rrugëve, apo për ndryshimin e këtyre emërtimeve. Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” vendimmarrjen për emërtimin e tyre ia njeh Këshillit Bashkiak.⁷

Pavarësisht ndarjes së kompetencave brenda një njësie të vetëqeverisjes vendore, Komisioneri vlerëson se në kuadër të bashkëpunimit dhe detyrimit ligjor për zgjidhjen e ankesave të publikut, është detyrim i një organi të Bashkisë Mallakastër që të përcjellë shqetësimet e personave, kërkesat apo ankesat një organi tjetër të po asaj njësie. Në rastin konkret ishte detyrim i administratës së Bashkisë Mallakastër që duhej t’ja dërgonte kërkesën organit të brendshëm kompetent të Bashkisë Mallakastër, Këshillit Bashkiak me përfaqësues Kryetarin e Këshillit Bashkiak.

Kodi i Procedurës Administrative (K.Pr.A), në nenin 71 të tij ka përcaktuar se: *“Organi publik, mund t’i kërkojë ndihmë administrative një organi tjetër publik, për kryerjen e një apo disa veprimeve të nevojshme, në kuadër të një procedure administrative”*.

Po ashtu, neni 134⁸ i K.Pr.A ka të shprehur në mënyrë të qartë se, edhe nëse kërkesa/ ankimi mund t’i jetë drejtuar gabimisht organit jo kompetent për shqyrtimin e saj, është detyrim ligjor i këtij organi që kërkesën t’ia përcjellë pa vonesë organit të përcaktuar me ligj për shqyrtimin e saj.

⁵Me adresë e-maili: dritan.dema@gmail.com .

⁶Me adresë e-maili: ballshi@bashkiamallakaster.gov.al.

⁷Neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, paragrafi 1.7, shkronja b) parashikon që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë të drejtë të “vendosin emërtimet e territoreve, objekteve dhe institucioneve nën juridiksionin e tyre, sipas kritereve të përcaktuara me ligj”.

Neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, ka parashikuar se: *“Këshilli Bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca: II)... Vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë”*.

⁸Përveçse kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi ndaj një akti administrativ mund t’i drejtohet organit publik që:

a) ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin; b) organit publik epror të organit të parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni; ose c) një organi tjetër publik të përcaktuar shprehimisht me ligj. 2. Nëse ankimi i është drejtuar njërit prej organeve të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, ato ia përcjellin pa vonesë organit kompetent. 3. Ankimi ndaj mosveprimit administrativ mund t’i drejtohet drejtpërdrejt organeve të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni. Nëse ankimi i është drejtuar organit të parashikuar në shkronjën “a”, të këtij neni, ai ia përcjell, pa vonesë, një prej organevetë parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, së bashku me dosjen e çështjes dhe një raport të shkruar për arsyet e heshtjes.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vëren se pavarësisht kërkesave të përsëritura drejtuar Bashkisë Mallakastër për ndryshimin e emërimit të rrugës “Mehmet Shehu”, kërkesve nuk u është kthyer asnjë përgjigje zyrtare.

Bazuar në detyrat dhe kompetencat që ligji nr. nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i njëj Këshillit Bashkiak, ky organ vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë”.

Këshilli Bashkiak Mallakastër, me Vendimin nr.27, datë 29.05.2002, në pikën 2, II, të tij ka vendosur të miratojë emërtimin e: “...Rrugës në drejtim të KPTHN-së “Rruga Mehmet Shehu”.

Neni 5/1, i LMD-së “Ndalimi i diskriminimit” parashikon se: “Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja nëshqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdoforme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.

Në këto kushte, referuar nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri gjykon se subjektet ankues i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Bashkisë Mallakastër, sa i takon pretendimit për mosmarrjen në shqyrtim të kërkesës për ndryshim të emërimit të rrugës “Mehmet Shehu”, për shkak të lidhjes së tyre familjare me z.J K(I ati). Theksojmë faktin se në parashtrimet e tyre drejtuar Bashkisë Mallakastër dhe Këshillit Bashkiak, ankuesit pretendojnë diskriminimin e tyre për shkak të lidhjes familjare me të ndjerin Kaceli.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në këto kushte, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri gjykon se subjektet ankuese i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Bashkisë Mallakastër, përmes mosveprimit të tyre sa i takon mospërcjelljes të kërkesës për ndryshim të emërimit të rrugës “Mehmet Shehu”, organit të Këshillit Bashkiak Mallakastër.

B. Shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2 të ligjit nr. 10221, datë 02.04.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Në të njëjtën frymë me LMD-në, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 18, të saj shpreh se “*1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.*”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues i pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, subjektet ankuese, kanë pretenduar se janë trajtuar në mënyrë diskriminuese për shkak të përkatësisë prindërore.

- Sa i përket përkatësisë prindërore.

Subjektet ankues pretendojnë diskriminim për shkak të përkatësisë prindërore, pasi janë të bijtë e z.J K. Në parashitimet dhe dokumentacionin e sjellë, ata kanë shpjeguar lidhjen familjare me z.J K (referuar Certifikatës së Zyrës së Gjendjes Civile të depozituar në dosje janë të bijtë e tij), si dhe kanë dhënë një panoramë të gjerë të kalvarit të vuajtjeve të familjes së tyre nga ish-regjimi komunist, duke renditur kronologjinë e ngjarjeve që nga arrestimi i paligjshëm i babait të tyre, z.J K, ekzekutimi i tij, dëbimi dhe internimi i nënës dhe shtatë fëmijëve; përfshirë dhe ankuesit si bashkëvuajtës.

⁹Neni 2: “*Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.*”

Përsa më lart, subjektet ankues kanë paraqitur prova dhe fakte, për të vërtetuar shkakun e pretenduar të përkatësisë prindërore.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar se faktin se subjektet ankues janë ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Mallakastër duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹⁰ dhe trajtimit të pafavorshëm të tyre.

Nga aktet e vëna në dispozicion gjatë shqyrtimit të ankesës, u konstatua se ankuesit e bartin shkakun e pretenduar dhe se institucioni ndaj të cilit ankohen, Bashkia Mallakastër, ka patur dijeni si për problematikën, ashtu edhe për faktin se ata janë bijtë e z.J K, i cili ishte dënuar dhe ekzekutuar nga regjimi komunist, në vitin 1951. (faktuar me procesverbalin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të datës 20 shkurt 1951, sjellë bashkëngjitur ankesës nga subjektet ankues).

Nga ana tjetër, Bashkia Mallakastër nuk ka treguar vullnet institucional për t’u angazhuar në përcjelljen e problematikës në organin e saj të brendshëm, në Këshillin Bashkiak, dhe aq më tepër të ndërmarrë veprime pozitive në këtë drejtim. Për shkak të ndjeshmërisë njerëzore së ankuesve, si bij të z.K, ekzekutimin e të cilit e kishte urdhëruar pikërisht njeriu, emrin e të cilit mban një nga rrugët që është në administrim territorial të kësaj Bashkie, dhe pasjes dijeni të këtij fakti nga ana e këtij institucioni; Bashkia nuk duhet të mbante qëndrim indiferent ndaj kërkesës së tyre dhe të mjaftohej thjesht me dhënien e përgjigjes se nuk është në kompetencën e saj të emërtojë rrugët.

Në këto kushte, duke analizuar faktet dhe dokumentacionin e grumbulluar gjatë trajtimit të ankesës, shpjegimet e dhëna nga palët, si dhe legjislacionin përkatës lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se paligjshmëria e veprimeve dhe mosveprimeve të Bashkisë Mallakastër në mosdhënien e një përgjigje mbi kërkesën e ankuesve, si dhe mos gjetja e një arsyeje të kësaj sjelljeje të kryer nga organi publik, krijon bindjen e një trajtimi disfavorizues dhe diskriminues kundrejt ankuesve për shkak të përkatësisë prindërore.

PËR KËTO ARSYE :

¹⁰Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Mbështetur në nenet 3, 4, 5, 7, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a/ç), pika 2 e tij, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, e 14 të ligjit nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Konstatimin e diskriminimit të subjekteve ankues: O K dhe M K nga ana e Bashkisë Mallakastër, përmes mosveprimit të tyre në trajtimin e problematikës.
2. Referuar pikës pikës 1, të vendimit, Bashkia Mallakastër, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj ankuesve, z.O K dhe z.M K; të trajtojë kërkesën e tyre për ndryshim të emërimit të "Rrugës Mehmet Shehu", në Këshillin Bashkiak Mallakastër.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Bashkia Mallakastër, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative.

Robert GAJDA

(shkaku: përkatësia prindërore)

(fusha: të mira dhe shërbime)

KOMISIONERI